



“QENDRA BURIMORE, KOMUNITARE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA” PEQIN

F T E S Ë

Të nderuar, z/znj. _____

Shoqata MEDPAK dhe Bashkia Peqin kanë kënaqësinë t’ju ftojnë të merni pjesë, ditën e enjte, datë 27.06.2013, ora 10.30, në sallën e Këshillit Bashkiak Peqin, në takimin me tematikë:

" Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale për personat me aftësi të kufizuara në Qendrën Burimore MEDPAK Peqin, synon të përmirësojë cilësinë e jetës së tyre dhe krijimin e një komuniteti gjithëpërfshirës. "

Takimi synon të prezantojë punën e bërë në Qendër , rezultatet e arritura deri tani dhe sfidat që na presin për të ardhmen, për ta kthyer në një qendër komunitare për gjithë grupet në nevojë të këtij qyteti të vogël.

Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuara u bë e mundur të hapet nga një projekt i përbashkët i Bashkisë Peqin me shoqatën MEDPAK dhe me mbështetje të Fondacionit Vodafone Albania.

Përfituesit e këtij projekti janë Personat me aftësi të Kufizuara dhe familjet e tyre : *116 persona me aftësi të kufizuara të lindura dhe të fituara gjatë jetës, 36 persona me aftësi të kufizuara në shikim, 16 persona të diagnostikuar me para dhe tetraplegji, pa përfshirë këtu personat me aftësi të kufizuara, invalid pune.*

Qendra Burimore për personat me aftësi të kufizuara, Peqin ofron shërbime psiko-sociale, vlerësim të nevojave dhe ndërtim të planeve të personalizuar për edukim, ndërgjegjësim të komunitetit , me qëllim realizimin e një komuniteti gjithëpërfshirës.

Në këtë takim janë ftuar të marrin pjesë institucionet vendore në bashki dhe në Qarkun e Elbasanit, Fondacioni Vodafone Albania , gjithë partnerët të cilët mbështesin shoqatën MEDPAK për realizimin e misionit të saj dhe shoqatat që punojnë për dhe me personat me aftësi të kufizuara në qarkun e Elbasanit.



PROGRAMI I TAKIMIT

Datë 27.06.2013, ora 10.30.

Me tematikë: Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale për personat me aftësi të kufizuara në Qendrën Burimore MEDPAK Peqin, synon të përmirësojë cilësinë e jetës së tyre dhe krijimin e një komuniteti gjithëpërfshirës

Ora 10.30 - 11.15 - Fjala e mirëseardhjes nga: Zela Koka , Shoqata MEDPAK

Fjala përshëndetëse nga

- Kryetari I bashkise Peqin.
- Drejtori ekzekutiv i Fondacionit Vodafone Albania
- Institucioni i Prefekturës së Qarkut – Elbasan
- Institucioni i Këshillit të Qarkut –Elbasan
- Përshëndetje nga një prind
- **Prezantim:** Qendra Burimore Për Personat me Aftësi të Kufizuara, një mbështetje e fortë për gjithë komunitetin e Peqinit.

Ora 11.15-11.30 - Pyetje , Diskutime

Ora 11.30 – 12.00 Vizitë në “Qendrën Burimore Komunitare për personat me aftësi të kufizuara”, Peqin.